



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 26/09/2024

DREJTUAR PËR PUBLIKIM: AGJENSISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË

LËNDA: FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

DREJTUAR FITUESIT Operatorit Ekonomik “VIBTIS” me Nr. Nipti L02103503S dhe me adresë: Tiranë-Rruga “Deshmorët e Kombit” Kullat Binjake, Kulla Nr. 2 Kati 8/4 Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedure e Hapur - Mallra mbi kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës/referenca **REF- 15652-08-07-2024** me objekt: “**Blerje paisje primare për N/stacionet elektrike të shpërndarjes**” me fond limit në vlerë: **99,880,000.00 (Nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.**

In Eur: - 994,919.00 Euro (Nine hundred ninety-four thousand nine hundred nineteen) Euro Without VAT.

Me afat 7 (Shtatë) muaj nga lidhja e kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 47 datë 12.08.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “VIBTIS” me Nr. Nipti L02103503S.

Vlera *945,483,000.00 (Nëntëqind e dyzetë e pesë mijë e katërqindë e tetëdhjetë e tre) euro pa TVSH.*



2. Operatori Ekonomik: “ENPI” shpk me Nr. Nipti K01409003B.

Vlera 99,880.000.00 (Nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqindë e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik: “ELB NDERTUESI” shpk me Nr. Nipti J93112212H.

Vlera 971,770.000.00 (Nëntëqindë e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqindë e shtatëdhjetë) euro pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik: “MAKHES GROUP” shpk me Nr. Nipti M22307001B.

Vlera 78,798,570.00 (Shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqindë e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqindë e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE: “ENPI” shpk me Nr. Nipti K01409003B.

Vlera 99,880.000.00 (Nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqindë e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. OE: “ELB NDERTUESI” shpk me Nr. Nipti J93112212H.

Vlera 971,770.000.00 (Nëntëqindë e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqindë e shtatëdhjetë) euro pa TVSH.

3. OE: “MAKHES GROUP” shpk me Nr. Nipti M22307001B.

Vlera 78,798,570.00 (Shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqindë e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqindë e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga **OE: “ENPI” sh.p.k. me Nr. Nipti K01409003B** referuar kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesave për kualifikim, pasi ka ngarkuar në SPE vetëm ofertën ekonomike dhe likuidimin e taksave vendore duke mos paraqitur asnjë dokumentacion tjetër në përmbushje të kritereve të kualifikimit.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga **OE: “ELB NDERTUESI” sh.p.k. me Nr. Nipti J93112212H** referuar kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesave për kualifikim, pasi ka ngarkuar në SPE vetëm ofertën ekonomike dhe shtojcën nr. 8 duke mos paraqitur asnjë dokumentacion tjetër në përmbushje të kritereve të kualifikimit.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga **OE: “MAKHES GROUP” shpk me Nr. Nipti M22307001B** referuar kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi si më poshtë vijon:

AK në DST ka kërkuar për Kapacitetin ekonomik dhe financiar:



2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Nga OE është vërtetimi i cili tregon se operatori ka vetëm një vitë që ushtron aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022,2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Nga OE është vërtetimi i cili tregon se operatori ka vetëm një vitë që ushtron aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.



2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë: kontraten, faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe vërtetimin e realizimit të kontratës me sukses.

Nga operatori ekonomik nuk janë paraqitur kontrata për furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e kontratës.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat të cilat verifikojnë që prodhuesi është në përputhje me të gjitha normativat CE sipas standarteve: EN 60947-2:2017, EN 61000-6-1:2007, EN 61000-6-3:2007+A1:2011, EN 61000-3-2:2014, EN 61000-3-3:2013 dhe një deklaratë ku merr përsipër se të gjithë mallrat e prodhuara për këtë procedurë prokurimi do të jenë sipas standarteve të mesiperme CE. AK do pranohet edhe mundësia e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit evropian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të kësaj kërkesë..



Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë saktësisht kolonën e emertuar “Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi” në të gjitha tabelat e paraqitura në shtojcën (Specifikimet teknike) të këtyre DT-ve.

Tabela me të dhënat teknike nuk është e plotësuar për çdo artikull.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se OE: “MAKHES GROUP” shpk me Nr. Nipti M22307001B” nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

Në perfundimin e vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit referuar nenit 82/2 të VKM nr. 285 i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

OE: “ENPI” sh.p.k. me Nr. Nipti K01409003B, OE: “ELB NDERTUESI” sh.p.k. me Nr. Nipti J93112212H dhe OE: “MAKHES GROUP” sh.p.k. me Nr. Nipti M22307001B s’kualifikohen për mospërmbushje të kriterëve për kualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se OE: “VIBTIS” me Nr. Nipti L02103503S sh.p.k me adresë: Tiranë-Rruga: “Deshmorët e Kombit” Kullat Binjake, Kulla Nr. 2 Kati 8/4, se oferta e paraqitur me vlerë totale 945,483,000.00 (Nëntëqind e dyzetë e pesë mijë e katërqindë e tetëdhjetë e tre) euro pa TVSH, totali i pikëve të marra (100) është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.



Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DREJTOR I DREJTORISË SË TENSIONIT TË LARTË OSSH SH.A.